



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 10041/prot.

Tiranë, më 08. 4.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1828, datë 27.12.2016.

**SHOQËRISË “COMBINED GROUP CONTRACTING COMPANY” SH.A
Rruga “Asim Vokshi”, Ndërtesa 4, Hyrja 4, Apartamenti 6, Tiranë.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Combined Group Contracting Company” sh.a është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1828, datë 27.12.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Vërdovë”, Pogradec, Korçë.

Leja minerare nr. 1828, datë 27.12.2016 është dhënë mbështetur në bazën ligjore në fuqi për veprimtarinë minerare, si karriere për qëllime publike vendore ose kombëtare, ku në pikat 1 dhe 4, të nenit 23, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku thuhet:

“1. Njësitë e qeverisjes vendore ose institucioni, i cili menaxhon projekte me rëndësi kombëtare, mund t'i propozojnë ministrit miratimin e zonave minerare - karriera, për t'u shfrytëzuar për qëllime publike vendore ose kombëtare, në sipërfaqet në pronësi të njësisë përkatëse”.....

“4. Leja e shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore ose kombëtare ka afat vlefshmërie jo më shumë se 3 vjet, me të drejtë rinovimi për një vit, sipas kërkesës së zotëruesit, e cila duhet të paraqitet, së paku, 30 ditë kalendarike përpara datës së mbarimit të lejes së mëparshme”.

Me shkresën e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) nr.6427, prot., datë 18.07.2018, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë nr.10041, datë 18.07.2018, është propozuar revokimi i lejes nr.1828, datë 27.12.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Vërdovë”, Pogradec, Korçë, sepse nuk është paguar garancia vjetore e rehabilitimit të mjedisit për vitin 2017 -2018.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germen “ç”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për

të cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sipas nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1828, datë 27.12.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Vërdovë”, Pogradec, Korçë**, që shoqëria juaj zotëron.

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1828, datë 27.12.2016, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Vërdovë”, Pogradec, Korçë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

